



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

MBI RISHPALLJEN E PLATFORMAVE TË PARTNERITETIT

FTESË PËR PJESËMARRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e institucionit kryesues për *Kapitullin 21 “Rrjetet Transevropiane”* po organizon tryezën e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dedikuar këtij kapitulli.

Kapitulli 21 përbën një prej kapitujve të *acquis* së Bashkimit Evropian dhe është një ndër kapitujt për hapjen e *Cluster-it* të 4-rt të negociatave të anëtarësimit. Një nga detyrimet kryesore të Shqipërisë në këtë fazë të integrimit është edhe përafrimi i legjislacionit. Në këtë kuadër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së bashku me institucionet e saj kontribuese, harton dhe miraton masat ligjore për përafrim me legjislacionin e BE-së nëpërmjet Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Në përmbushje të detyrimeve tona të përbashkëta sa i takon integrimit të Shqipërisë në BE, kjo *Tryezë Partneriteti* do t’i japë mundësinë të gjitha palëve që të sigurojnë një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe profesional. Prania dhe njohuritë tuaja janë një faktor i pazëvendësueshëm në mbështetje të këtij procesi që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e vlerëson në mënyrë të veçantë.

Për të qenë pjesë e kësaj tryeze ftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, mediave të cilët kanë interes për të ndarë ekspertizën e tyre në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës energjetike, përfshirë udhëzimet e Komunitetit për zhvillimin e Rrjeteve Trans-Evropiane dhe masat mbështetëse për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët. Përcaktimi dhe zhvillimi i Rrjeteve Trans-Evropiane, si dhe promovimi i ndërlidhjes së duhur dhe ndërveprimit të rrjeteve kombëtare synojnë të përfitojnë plotësisht nga tregu i brendshëm dhe të

kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e punësimit në vend dhe më gjerë si pjesë e *Kapitullit 21*.

Aplikimi kryhet duke depozituar nje letër interesi ku të jenë specifikuar eksperiencat e mëparshme në fushat e mësipërme si dhe ekspertiza që mund të jepet lidhur me fushat që mbulon *Kapitulli 21* “*Rrjetet Transevropiane*” dhe CV të personit apo grupimit që përfaqëson, brenda datës **13.05.2022** në adresat elektronike :

- Ermira.rapushi@infrastruktura.gov.al

- Erida.sinanaj@infrastruktura.gov.al

- Leandro.xhama@infrastruktura.gov.al